



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRIŠTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/21/22

Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga pala M.S ndaj gjyqtarit A.T, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 20.05.2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga M.S ndaj gjyqtarit A.T për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

Pala M.S me datë 22.04.2022 ka paraqitur ankesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.T në Gjykatën Themelore në Prishtinë. E njëjta ankesë me datë 28.04.2022 është pranuar edhe përmes Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Me datë 05.05.2022 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës për pranimin e ankesës.

Parashtruesi i ankesës M.S ka paraqitur ankesë ndaj gjyqtarit për shkak të pretendimeve se në lëndën C.nr.2342/21 i ka fshehur provat kryesore, ka shqyrtuar padinë me prova të falsifikuara dhe ka injoruar kundërpadinë, për faktin se pala paditëse nuk është pronar i tokës. Tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se, gjatë seancave gjyqësore gjyqtari i rastit ka qenë i njëanshëm, duke e ka penguar t'i prezantoj provat dhe ka anuar nga pala paditëse, dhe e ka injoruar Ujdinë Gjyqësore C.nr.1414/2009. Ka shtuar se, me këto veprime gjyqtari ia ka shkelur të drejtat e tij.

Në lidhje me pretendimet e parashtruesit të ankesës, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se, lënda C.nr.2342/21 është përfunduar dhe gjendet në shkrimoren civile. Ka shtuar se, pretendimet e palës ankuese janë të pa vërteta ngase lënda në fjalë është trajtuar për pengim posedim, pra kur ka ndodhur akti i pengim posedimit dhe në cilën pjesë të oborrit. Gjykata duke i ndërmarr të gjitha veprimet procedurale siç janë; dalja në vendshiqim me ekspertin e Gjeodezisë ka zbatuar

me përpikëri procedurën kontestimore sa i përket çështjes së pengim posedimit. Tutje, gjyqtari i çështjes ka theksuar se, sa i përket pretendimeve se gjyqtari i ka bërë të pa drejta, kjo mund të verifikohet lehtë ngase paditësi te ai si gjyqtar kishte për shqyrtim lëndën që ka të bëjë me pengim posedimin, ndërsa lëndën për ndarjen e pasurisë e kanë të iniciuar tek gjyqtaret tjerë. Ka shtuar se, sipas nenit 480 të LPK-së, parashihet se: “Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përfshihet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërinë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit”, dhe se ai si gjyqtar ka nxjerr vendimin dhe ka zbatuar dispozitat ligjore në përpikëri duke i trajtuar të gjitha palët në mënyrën e barabartë duke i dhënë palëve ndërgjyqëse të gjitha mundësit të cilat i parasheh ligji.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit A.T.

Autoriteti Kompetent i kësaj Gjykate bazuar në faktet e çështjes ka gjetur se, nuk ka baza të arsyeshme për inicimin e hetimeve për shkelje disiplinore në veprimet e gjyqtarit A.T lidhur me aktvendimin e marrë, për të cilat parashtruesi është ankuar.

Lidhur me pretendimin e palës ankuese se gjyqtarit A.T ka qenë i njëanshëm në veprimet e tij gjatë procedurës në lëndën C.nr.2342/21 se nuk i ka marrë parasysh provat e palës së paditur, tashmë parashtruesit të ankesës, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate, vlerëson se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë të palëve në procedurë, i përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, sepse te rastet e pengim posedimit – sipas dispozitave ligjore, gjykata kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë, e në këtë rast gjykata ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale sipas udhëzimeve të Gjykatës së Apelit, kurse rastin tjetër të cilën e ka parashtruesi në këtë gjykatë, për vërtetim pronësie, gjendet te gjyqtari tjetër i kësaj gjykate, ndaj të cilit ankuesi nuk ka paraqitur ankesë disiplinore.

Ndërsa, në lidhje me vendimmarrjen e gjyqtarit për Aktvendimin C.nr.2442/21, Autoriteti i kësaj gjykate vë në pah se nuk ka të drejtën e komentimit apo ndryshimit të vendimit të marrë nga gjykata përkatësisht nga gjyqtari, sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtari vepron konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi.

Sa i përket pretendimeve se gjyqtari ka qenë i njëanshëm gjatë seancave gjyqësore, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se pretendimet e tilla nuk janë dëshmuar me asnjë provë, për më tepër nga shkresat e lëndës, konkretisht nga procesverbalet e seancave gjyqësore, rezulton se parashtruesi i ankesës, dhe i autorizuari i tij, nuk kanë kërkuar përjashtimin e gjyqtarit të çështjes gjatë procedurës gjyqësore, por ankesa disiplinore është paraqitur pasi është marrë aktvendimi me të cilin është refuzuar kundërpadia e tij, dhe për këtë vlerëson se nuk është shkelur parimi i pavarësisë dhe paanësisë i përcaktuar me dispozitën e nenit 5, par.2, nën-paragrafi 2.1 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Ndërsa, për aplikimin e gabuar të së drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtarit/ve gjatë punës së tyre, mund të jetë shkak për ushtrimin mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme në gjykatat e instancave më të larta nga pala e pakënaqur por nuk mund të konsiderohet shkelje disiplinore.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të Rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/21/22, me datë 20.05.2022

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë